

**Intervistë për MIA me ambasadorin Clemens Koja,
Shef i Misionit të OSBE-së në Shkup
Data: 06 shkurt 2021**

- 1. Parlamenti miratoi ligjin për regjistrim, duke hapur kështu rrugën që regjistrimi të mbahet në muajin prill. A ofron legjislacioni aktual një numërim cilësor të banorëve?**

Faleminderit për pyetjen. Është inkurajuese që disa nga partitë opozitare mbështetën miratimin e këtij ligji, edhe pse nuk kishte konsensus të plotë. Pas gati 20 vjetësh, është e rëndësishme që vendi të kryejë një regjistrim, pasi kjo do të lejojë institucionet qeveritare të zhvillojnë dhe zbatojnë politika për të mirën e qytetarëve bazuar në të dhëna të azhurnuara. Për aq sa jam i informuar, ligji u hartua nga praktikantët dhe standardet më të mira nga institucione të ndryshme dhe me relevancë në këtë fushë, siç janë Komisioni Ekonomik i OKB-së për Evropë dhe Eurostat.

- 2. Cilat janë përvojat e Shteteve pjesëmarrëse të OSBE-së lidhur me organizimin e këtij operacioni? Opozita në vend kërkon regjistrim elektronik.**

Angazhimet e OSBE-së nuk përfshijnë kryerjen e operacioneve të regjistrimit dhe shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së përdorin një larmi modelesh. Mund t'ju them se shumë shtete pjesëmarrëse po planifikojnë të kryejnë operacione regjistrimi këtë vit. Këto do të jenë operacione veçanërisht sfiduese këtë vit, duke pasur parasysh pandeminë me COVID-19. Do të jetë e rëndësishme për qeverinë që të vendosë protokolle të qarta të shëndetit dhe sigurisë që garantojnë sigurinë dhe shëndetin e stafit në terren, si dhe të familjeve të anketuara. Përvoja e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare në korrik të vitit 2020 më shtyn të besojë se do të ndiqen protokollat e vendosura.

- 3. Pastrimi në gjyqësor mbetet akoma në fokus. OSBE monitoron çështje gjyqësore politikisht të ndjeshme. A jemi në rrugën e duhur për të rivendosur besimin në gjyqësor dhe sundimin efikas të ligjit?**

Që kur arrita këtu në Shkup, u habita nga niveli shumë i ulët i besimit të publikut në sistemin gjyqësor në bazë të sondazheve të opinionit publik. Ne kemi vërrejtur disa hapa drejt reformave në vitet e fundit, përfshi miratimin e Strategjisë për Reforma në Drejtësi 2017-2022, të cilën Misioni ynë e mbështeti. Ne gjithashtu kemi ofruar një numër rekomandimesh për adresimin e çështjeve problematike

që kemi vërejtur gjatë monitorimit tonë të gjerë të gjykimeve, përfshi gjykimet e ish-Prokurorisë Speciale. Jemi duke ndjekur zhvillimet aktuale, përfshi miratimin e metodologjive për vlerësimin e punës së gjyqtarëve dhe prokurorëve nga ana e Këshillit Gjyqësor, si dhe Këshillit të Prokurorëve Publikë në fund të vitit të kaluar. Unë besoj se zbatimi i duhur i këtyre kontrolleve do të jetë një hap drejt rivendosjes së besimit në gjyqësor.

- 4. Cili është vlerësimi juaj për reformat në media? Çështje aktuale për momentin në Kuvend është propozimi mbi ndryshimin e procesit për zgjedhjen dhe emërimin e anëtarëve të Këshillit Programor të MRT-së dhe Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale. Të gjitha organizatat e gazetarëve kishin vërrejtjet e tyre rreth kësaj çështje.**

Vonesa në mbajtjen e zgjedhjeve parlamentare vitin e kaluar për shkak të COVID-19 pengoi zbatimin e reformave në media. Jam i lumtur të shoh se qeveria tani po i kthehet kësaj çështjeje të rëndësishme. Pjesa e audiencës së transmetuesit publik (MRT) është shumë e ulët, gjë që tregon se njerëzit duan të shohin ndryshime atje. Është e rëndësishme të forcohet kapaciteti i transmetuesit publik për të ofruar informacion të paanshëm dhe të promovojë kohezionin social përmes përmbajtjes që plotëson nevojat e të gjithë qytetarëve.

Gjatë viteve të fundit, Misioni ynë ka punuar intensivisht për të ndihmuar në rritjen e sigurisë së gazetarëve në këtë vend. Megjithëse renditja e lirisë së mediave në Maqedoninë e Veriut po përmirësohet, ne po vërrejmë një numër në rritje të rasteve të ngacmimit dhe sulmeve në internet kundër gazetarëve femra, sidomos rreth kohës së zgjedhjeve. Ne planifikojmë të vazhdojmë bashkëpunimin me organet për zbatimin e ligjit, gjyqësorin dhe mediat në përpjekjet e tyre për trajtimin e këtij kërcënimi për rrjedhën e lirë të informacionit të besueshëm për të cilin qytetarët kanë aq shumë nevojë duke pasur parasysh të gjitha keqinformimet dhe dezinformatat të cilave u ekspozohen, veçanërisht në internet.

- 5. Është viti i zgjedhjeve pasi vendi është para mbajtjes së zgjedhjeve të rregullta lokale. Kishte rekomandime që buronin nga zgjedhjet e mëparshme parlamentare, dhe sërish ka paralajmërime për një njësi të vetme zgjedhore, lista të hapura, etj. A është e pranueshme që legjislacioni zgjedhor të ndryshohet gjatë një viti zgjedhor?**

Sipas ODIHR, është e këshillueshme që legjislacioni zgjedhor të hyjë në fuqi të paktën gjashtë muaj përpara zgjedhjeve, në mënyrë që institucionet të përgatiten për zbatimin e lehtë të ndryshimeve.

Gjatë viteve, ODIHR ka ofruar një numër të konsiderueshëm të rekomandimeve për përmirësimin e procesit zgjedhor në Maqedoninë e Veriut. Në raportin e tyre përfundimtar mbi zgjedhjet e parakohshme parlamentare të vitit të kaluar, Misioni Special për Vlerësim të Zgjedhjeve i ODIHR-it bëri të qartë se akoma ekziston një numër çështjesh që duhen të adresohen lidhur me kornizën ligjore për zgjedhjet.

ODIHR nuk rekomandon një model specifik zgjedhor, dhe Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së përdorin një gamë të gjerë modelesh të ndryshme elektorale, si dhe sisteme të ndryshme për administrimin e zgjedhjeve. Duke pasur parasysh rëndësinë e këtyre çështjeve, ne mbështesim fuqimisht një proces gjithëpërfshirës ku të gjithë palët e interesuara mund të diskutojnë idetë e tyre për reformën zgjedhore që do të forconte përfaqësimin e qytetarëve dhe në këtë mënyrë edhe legjitimitetin e zyrtarëve të zgjedhur. Jemi të kënaqur që Ministria e Drejtësisë ka formuar një grup pune për reformën e Kodit zgjedhor që përfshin partitë politike dhe grupet e shoqërisë civile me ekspertizë mbi zgjedhjet. Në këtë grup pune marrin pjesë gjithashtu Misioni ynë dhe ODIHR.

6. Muajin e kaluar u zgjodhën anëtarët e rinj të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve (KSHZ). Sfida e tyre e parë është të organizojnë dhe administrojnë zgjedhjet lokale, të planifikuara të mbahen në vjeshtë. A është duke u shndërruar KSHZ-ja më tepër në një organ partiak sesa profesional?

Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve (KSHZ) është partner i vjetër i Misionit tonë dhe gjithashtu edhe i ODIHR-it. Ne presim që përbërja e re e KSHZ-së të kryejë detyrat e tyre në mënyrë që është plotësisht në përputhje me legjislacionin ekzistues, rregullat dhe procedurat, përfshi betimin solemn që anëtarët kanë nënshkruar. Vlen të përmendet se KSHZ nuk është vetëm komisioni prej shtatë anëtarësh. Ai gjithashtu përfshin stafin administrativ, të cilët kanë treguar nivel të lartë profesionalizmi dhe përkushtimi gjatë gjithë viteve.

7. Viti 2020 u shënua nga pandemia e koronavirusit, e cila shkaktoi pasoja të rënda shëndetësore dhe ekonomike në mbarë botën. Çfarë lloj aktiviteteve po zhvillon

OSBE për të ndihmuar vendin të trajtojë pandeminë me COVID-19, dhe të cilat janë në përputhje me mandatin e Misionit të OSBE-së?

Tashmë pranverën e kaluar, ne i dhuruam qeverisë pajisje mbrojtëse personale për punonjësit mjekësorë, policinë dhe personat e tjerë në vijën e parë. Ne gjithashtu i dhuruam një veturë Degës së Kryqit të Kuq në Tetovë për t'iu mundësuar atyre të ofrojnë mbështetje për qytetarët e prekshëm që jetojnë në zona të largëta, si dhe dhuruam gjithashtu pajisje sigurie për gazetarët në mënyrë që ata të vazhdojnë punën e tyre të rëndësishme duke informuar publikun gjatë pandemisë.

Ne gjithashtu organizuam një iniciativë për ofrimin e granteve të vogla për organizatat e shoqërisë civile që ata të ndihmojnë njerëzit në nevojë dhe grupet e privuara të qytetarëve, përfshi njerëzit me aftësi të kufizuara, të rinjtë dhe të moshuarit, komunitetet më të vogla, të mbijetuarit e dhunës në familje dhe shumë të tjerë. Gjithsej, ne dhuruam më tepër se 150,000 Euro në grante për 11 organizata, të cilat u zgjodhën në mesin e 110 aplikantëve përmes një procesi konkurrues.

Siç e dini, Misioni ynë ka mbështetur prej kohësh reformën dhe profesionalizimin e organeve të zbatimit të ligjit dhe gjyqësorit. COVID-19 krijoi sfida të rëndësishme për të dyja. Përveç ofrimit të pajisjeve mbrojtëse për policinë, ne ofruam gjithashtu trajnime për menaxhimin e stresit për nëpunësit policor dhe anëtarët e Odës së Kompanive Private të Sigurisë, anëtarët e së cilës ofrojnë siguri të infrastrukturës kritike. Gjithashtu përkrahëm Shoqatën e Gjyqtarëve në zhvillimin e protokolleve për mbajtjen e sigurt të gjykimeve gjatë pandemisë, si dhe mbështetëm përpjekjet për të digjitalizuar sistemin gjyqësor.

E fundit, por jo më pak e rëndësishmja, ne mbështetëm hartimin e një analize të ndikimit të pandemisë tek burrat dhe gratë, e cila tregoi se pandemia kishte efekt negativ tek gratë në mënyrë disproporcionale. Duke e njohur këtë sfidë gjatë fazës fillestare të krizës, ne mbështetëm grupet që ofrojnë linja ndihme për raportimin e rasteve të dhunës në familje.

8. Kryesimi aktual i Suedisë me OSBE-në theksoi barazinë gjinore në të gjitha aspektet e punës së Organizatës dhe përfshirjen e shoqërisë civile si një nga përparësitë e saj kryesore. Ministrja e Jashtme suedeze Ann Linde theksoi se arritja e një sigurie gjithëpërfshirëse në

të gjithë rajonin kërkon përfshirje domethënëse dhe fuqizim të grave. Si ecim në këtë drejtim?

Në postimin tim të fundit në revistën 'Ballë për ballë', vura në dukje se barazia gjinore është një aspekt thelbësor për stabilitetin dhe sigurinë e çdo vendi. Unë mendoj se është qenësore që vendi të angazhohet për t'i dhënë fund dhunës me bazë gjinore. Duke pasur parasysh këtë, ne mirëpresim miratimin e fundit të Ligjit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna ndaj Grave dhe Dhunën në Familje. Na erdhi mirë kur vërrejtëm se ligji fitoi mbështetje nga të gjitha partitë dhe jemi krenarë që kontribuova në procesin e hartimit të kësaj pjese të rëndësishme të legjislacionit.

Misioni ynë është veçanarisht i përkushtuar në përkrahjen e fuqizimit të grave dhe rritjen e pjesëmarrjes së tyre në vendimmarrje. Në vitin 2017 filluam një Program Mentorues për Gratë në Polici dhe vitin e kaluar krijuam një program të ngjashëm për gratë që punojnë në të gjithë administratën publike. Ne besojmë se këto programe ndihmojnë pjesëmarrësit të rriten profesionalisht dhe i përgatisin ata në marrjen e roleve më të larta vendimmarrëse në administratë.

9. Propozim-koncepti për reformat në arsimin fillor është një çështje aktuale. Cili është mendimi juaj?

Sistemi arsimor është pasqyrim i shoqërisë dhe kërkesave të tregut të punës. Kjo është një arsye pse është e nevojshme që sistemi arsimor të rishikohet shpesh. Rezultatet e Programit për Vlerësimin e Studentëve Ndërkombëtarë si në vitin 2015 ashtu edhe në vitin 2018 tregojnë se sistemi arsimor duhet të vendos një theks më të fortë në rritjen e kompetencave të të diplomuarve. Kjo është arsyeja pse, unë e shoh zhvillimin e një koncepti të ri për arsimin fillor si një hap praktik drejt rritjes së rezultateve të procesit arsimor.

10. Gjatë mandatit tuaj në vend, ju ishit dëshmitar i momenteve të rëndësishme për vendin, përfshi referendumin për emrin, anëtarësimin e plotë në NATO, miratimin nga udhëheqësit e BE-së për të filluar negociatat, dhe gjithashtu veton e Bullgarisë për hapjen e negociatave. Ku e shihni të ardhmen e vendit?

Që nga ardhja ime në shtator të vitit 2018, vendi ka bërë përparim të konsiderueshëm në zbatimin e agjendës ambicioze të reformave. Jam krenar që Misioni ynë ka mbështetur reformat në fushat kryesore, siç është sundimi i ligjit,

si dhe lufta kundër një sërë kërcënimesh transnacionale. Unë vlerësoj përqendrimin e qeverisë në përmirësimin e marrëdhënieve me fqinjët tuaj, gjë që ka kontribuar për sigurinë në rajon.

Për të ardhmen, do të inkurajoja vendin të vazhdojë rrugën e reformave për të përmirësuar më tej fusha të tilla si luftimi i korrupsionit, promovimi i reformës së administratës publike dhe luftimi i krimit të organizuar, gjatë gjithë kohës duke nxitur sundimin e fortë të ligjit dhe pavarësinë e gjyqësorit.

11. Në Këshillin Ministror të OSBE-së në muajin dhjetor të vitit të kaluar në Tiranë, Maqedonisë së Veriut iu ofrua kryesimi i OSBE-së në vitin 2023. Çfarë do të thotë për Maqedoninë e Veriut duke pasur parasysh përvojën tuaj shumëvjeçare si diplomat dhe përvojën tuaj si ambasador i Austrisë në OSBE gjatë Kryesisë austriake të OSBE-së?

Së pari, më lejoni të përgëzoj edhe një herë Maqedoninë e Veriut për kryesimin e OSBE-në në vitin 2023. Oferta e vendit për të kryesuar Organizatën paraqet një angazhim për multilateralizëm efektiv, qasje të sigurisë gjithëpërfshirëse dhe të bashkëpunimit të OSBE-së. Duke folur nga përvoja personale, duhet të them se kryesimi i Organizatës sonë nuk është një detyrë e lehtë pasi kërkon një ekip të fortë ekspertësh, durim, qëndrueshmëri dhe vendosmëri politike. Por unë kam besim se vendi, i cili tashmë ka filluar përgatitjet për vitin 2023, do të sigurojë një udhëheqje të fortë për Organizatën. Dhe sigurisht, Maqedonia e Veriut fillon me një avantazh, siç e dini punën e misionëve të OSBE-së, si Misioni ynë, në mbështetjen e proceseve të sigurisë dhe reformës.